



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal i Deçanit, në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.01.2018, nxjerrë këtë:

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT DHE TË RREGULLOREVE KOMUNALE

I.

Formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin Statutit të Komunës së Deçanit dhe të Rregulloreve komunale, në këtë përbërje:

1. Lirije Zukaj (AAK),
2. Besjana Ukëhaxhaj(AAK),
3. Florim Mataj(AAK),
4. Shkelqesa Hadergjonaj(PDK),
5. Rejhana Tolaj(LDK),
6. Jashar Dobraj nga Ekzekutivi
7. Halil Tolaj nga Ekzekutivi

Mbledhja e parë e Komisionit ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje Komisioni e zgjedhë Kryesuesin e vet.

II.

Detyrë e Komisionit është që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të Statutit të Komunës së Deçanit, dhe harmonizimin e Statutit me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe shqyrtimin e të gjitha rregulloreve komunale dhe harmonizimin e tyre me Ligjin për vetëqeverisje Lokale.

Pas harmonizimit të dispozitave të Statutit dhe të Rregulloreve Komunale me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komisioni i dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit.

III.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Kryetari dhe Arhivi.

01.Nr.I-9

Deçan,dt.31.01.2018

KUVENDI KOMUNAL I DEÇANIT

HYRESE-ULAZMA-INGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DECANI MUNICIPALITY

Nr. Prot: 3498
Pr. Prot. No. 3498

Nr. i ftoqesve: 01
Ar. Stranegar: 01
No. Pages: 01

INÇAN DECANI



Kryesusi:
Haki Shehaj